

ODA EKONOMIKE - KOSOVA CHAMBER
E KOSOVËS OF COMMERCE
NO: 254
31.05.2019
PRISHTINË



ODA EKONOMIKE KOSOVA CHAMBER
E KOSOVËS OF COMMERCE

Adresa: Nëna Terezë, Nr.20, 10000 Prishtinë - KOSOVË
Tel: +381 (0) 38 224 741, Tel&Fax: +381 (0) 38 224 299
Info@oek-kcc.org, www.oek-kcc.org

RREGULLORE

**MBI MËNYREN E PUNËS SË KËSHILLIT MBIKËQYRËS TË ODËS EKONOMIKE TË
KOSOVËS**

Prishtinë, Maj 2019

Në bazë të nenit 20 të Ligjit mbi Odën Ekonomike të Kosovës dhe nenit 35 të Statusit të Odës Ekonomike të Kosovës, Këshilli Mbikëqyrës i Odës ekonomike të Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 31.05.2019, miratoi, këtë:

RREGULLORE

MBI MËNYREN E PUNËS SË KËSHILLIT MBIKËQYRËS TË ODES EKONOMIKE TË KOSOVËS

Dispozitat e përgjithshme

Neni 1

Me këtë rregullore përcaktohet mënyra e punës së Këshillit Mbikëqyrës të Odës Ekonomike të Kosovës (në tekstin e mëtejshëm: KM), procedura e miratimit të akteve të Këshillit Mbikëqyrës, të drejtat, detyrat dhe përgjegjësitë e anëtarëve të Këshillit Mbikëqyrës, procedura e miratimit të akteve të Këshillit Mbikëqyrës, kriteret dhe kompetencat e pavarura të anëtarëve të Këshillit Mbikëqyrës si dhe çështjet e tjera të rëndësishme për mbarëvajtjen e punës së Këshillit Mbikëqyrës .

Neni 2

2.1.Themelimi dhe Përgjegjësit e Këshillit Mbikëqyrës të OEK-ut

2.1.1. Këshilli Mbikëqyrës i Odës ka kryesuesin dhe 4 anëtarë (gjithsej 5 anëtarë) që zgjidhen nga radhët e përfaqësuesve të anëtarëve të Odës. Anëtar të Këshillit Mbikëqyrës mund të zgjidhen edhe ekspertë në lëmin e punës materiale – financiare.

2.1.2. Mandati i anëtarëve të Këshillit Mbikëqyrës zgjat 4 vjet me të drejtë të rizgjedhjes edhe për një mandat.

2.1.3. Kuvendi i Odës zgjedhë Këshillin Mbikëqyrës të Odës nga radha e përfaqësuesve të anëtarëve që nuk janë anëtarë të Kuvendit, Këshillit Drejtues, dhe stafit udhëheqës dhe menaxherial të Odës.

2.1.4. Këshilli Mbikëqyrës kontrollon veprimtarinë financiare dhe materiale të Odës.

2.1.5. Përbërja, fushëveprimi dhe autorizimet e Këshillit Mbikëqyrës përcaktohen me Statusin e Odës Ekonomike të Kosovës.

Neni 3

3.1 Kriteret dhe administrimi i mbajtjes se mbledhjeve te Këshillit Mbikëqyrës:

3.1.1 Mbledhjen e Këshillit e udhëheq kryesuesi, në mungese të tij e udhëheq anëtari i autorizuar nga kryesuesi.

3.1.2 Nëse ndonjëri nga radhët e anëtarëve të Këshillit Mbikëqyrës mungon 3 here pa arsye në mbledhjen e Këshillit Mbikëqyrës të OEK-ut, në rast të dorëheqjes së anëtarit të Këshillit, atëherë anëtarët e Këshillit Mbikëqyrës, në konsultim me kryesuesin e Këshillit Mbikëqyrës, i propozojnë Këshillit Drejtues të OEK-ut që përmes Kuvendit të OEK-ut, të rishikohet përbërja e Këshillit Mbikëqyrës, dhe në këto raste të zgjidhet kryesuesi dhe anëtari tjetër i Këshillit Mbikëqyrës të OEK-ut, nga radhët e anëtarëve të OEK-ut.

3.1.3 Në mungesë të kryesuesit të Këshillit Mbikëqyrës, me arsye objektive, mbledhjet i mban anëtari i autorizuar. Nëse kryesuesi i Këshillit Mbikëqyrës mungon 3 herë në mbledhje pa arsye, atëherë Këshilli e shqyrton çështjen dhe kërkon largimin e kryesuesit të Këshillit Mbikëqyrës nga pozita e kryesuesit, dhe ndjekjen e procedurës sipas Ligjit të OEK-ut, për zgjedhjen e kryesuesit tjetër të Këshillit Mbikëqyrës.

Neni 4

4.1. E drejta e mbajtjes se mbledhjeve te Këshillit Mbikëqyrës te OEK-ut:

4.1.1. Mbledhjet e Këshillit Mbikëqyrës të OEK-ut, i fton kryesuesi i Këshillit Mbikëqyrës, se paku 2 herë në vit, ndërsa të drejtën për të kërkuar mbajtjen e mbledhjes së Këshillit Mbikëqyrës më shumë se 2 here në vit, sipas nevojës dhe problematikes se procesit në mbikëqyrjen e proceseve në OEK, e kanë të drejtën edhe 1/3 e anëtarëve të tjerë të Këshillit Mbikëqyrës të OEK-ut.

Neni 5

5.1. Administrimi i mbledhjeve të Këshillit Mbikëqyrës të OEK-ut:

5.1.1. Administrimin e materialit për mbledhje të Këshillit Mbikëqyrës e përgatit kryesuesi i Këshillit Mbikëqyrës në konsultim, koordinim dhe bashkëpunim me Kryetarin e OEK-ut dhe Sekretarin e Përgjithshëm të OEK-ut.

5.1.2. Rendin e ditës së mbledhjes së Këshillit Mbikëqyrës e përcakton Këshilli Mbikëqyrës .

5.1.3. Pas aprovimit të procesverbalit dhe përcaktimit të rendit të ditës, Këshilli Mbikëqyrës kalon në shqyrtimin e çështjeve nga rendi i ditës , ashtu siç janë të renditura në rend të ditës.

5.1.4. Shqyrtimi i çdo çështjeje nga rendi ditës bazohet ose në sqarimin e propozuesit ose në sqarimet edhe me shkrim nga propozuesi.

5.1.5. Pas shqyrtimit të çështjes nga rendi i ditës e varësisht nga karakteri i çështjes e cila shqyrtohet, Këshilli Mbikëqyrës nxjerr vendim, konkluzë apo akt tjetër, përkatësisht përcakton propozimet e akteve të cilat i përkasin fushëveprimit të Kuvendit të Odës.

5.1.6. Nëse çështja e cila shqyrtohet në mbledhjen e Këshillit Mbikëqyrës nuk kërkon nxjerrje të ndonjë vendimi apo konkluzë përkatësisht përcaktimit të propozimit, kalohet në pikën vijuese të rendit të ditës.

5.1.7. Anëtari i Këshillit Mbikëqyrës mund të paraqesë propozim, konkluzë ose çështje në rendin e ditës të mbledhjes së Këshillit Mbikëqyrës. Propozimi, zakonisht, parashtrohet para apo gjatë mbajtjes së mbledhjes. Nëse ka më shumë propozime apo konkluzë për të njëjtën çështje të rendit të ditës, kryesuesi i mbledhjes, propozimin e vënë në votim sipas rendit të paraqitjes së tyre. Para se të kalohet në shqyrtimin e propozimit apo konkluzës të paraqitur, kryesuesi i mbledhjes do të kërkojë mendimin apo diskutime për propozimin e paraqitur. Nëse propozimi aprovohet, ai bëhet pjesë përbërëse e rendit të ditës.

5.1.8. Materialet e mbledhjes së Këshillit Mbikëqyrës, duhet të jenë përmbledhëse dhe të qarta dhe përveç vlerësimit të gjendjes duhet të përfshijnë edhe propozimet e qëndrimeve dhe të konkluzioneve.

5.1.9. Anëtarët e Këshillit Mbikëqyrës të OEK-ut, duhet të informohen për mbledhje së paku 3 dite para datës së caktuar të mbledhjes së Këshillit Mbikëqyrës të OEK-ut, njëkohësisht materiali për rendin e ditës t'iu shpërndahej anëtarëve të Këshillit 3 dite përpara mbledhjes.

5.1.10. Në çdo mbledhje të Këshillit Mbikëqyrës nga kryesuesi verifikohet pjesëmarrja e anëtarëve të Këshillit Mbikëqyrës. Për mbajtjen e mbledhjeve të këtij Këshilli duhet të ketë kuorum, se paku 3 (tre) anëtarë duhet të jenë prezentë në mbledhje.

5.1.11. Për punën e zhvilluar të mbledhjes së Këshillit Mbikëqyrës mbahet procesverbali, i cili përgatitet dhe pastaj iu shpërndahej anëtarëve të Këshillit në mbledhjen e radhës, dhe anëtarët e këtij Këshilli kanë të drejtën që të japin vërejtjet e veta në procesverbal të mbledhjes se kaluar, dhe pastaj me vërejtje të plotësuar të miratohet nga anëtarët e KM-se, si dhe të nënshkruhet nga procesmbajtësi dhe kryesuesi i Këshillit Mbikëqyrës.

5.1.12. Procesverbalet e mbledhjeve ruhen në arkivin e OEK-ut. Procesverbali përmban të dhënat kryesore për mbledhjen ,përkatësisht për rrjedhën e saj: numrin e seancës, datën e mbajtjes, vendin e mbajtjes, orën e fillimit dhe mbarimit, numrin e të pranishmëve dhe emrat e anëtarëve të Këshillit Mbikëqyrës që mungojnë nga mbledhja, me shënim lidhur me arsyeshmërinë e mungesës si dhe emrat e personave të tjerë të ftuar që marrin pjesë në punën e mbledhjes; propozimet e paraqitura, rendin e ditës, vendimet dhe konkluzat e miratuara në mbledhjen e Këshillit Mbikëqyrës ,rezultatet e votimit për pikat e caktuara etj.

5.1.13. Anëtari i Këshillit Mbikëqyrës dhe pjesëmarrësit e tjerë në mbledhje kanë të drejtë të shikojnë diskutimet e veta se a janë shënuar në procesverbal dhe në to ti kryejnë përmirësimet.

5.1.14. Këshilli Mbikëqyrës është i obliguar që 1 herë në 6 muaj brenda vitit kalendarik të përpilojë raport pune lidhur me punën dhe aktivitetet e veta, i cili duhet ta miratojë, dhe t'ia paraqesë Këshillit Drejtues të OEK-ut dhe Kuvendit të OEK-ut.

5.1.15. Mbledhja e Këshillit mund të shtyhet ose të ndërpritet në rastet kur nuk ka kuorum, kur mbledhja nuk mund të kryhet në kohën e planifikuar (zgjat shumë). Mbledhjen e Këshillit Mbikëqyrës e shtyn dhe e ndërpret kryesuesi i Këshillit.

Neni 6

6.1. Votimi në mbledhjen e Këshillit Mbikëqyrës është publik, nëse Këshilli Mbikëqyrës nuk vendos ndryshe. Votimi bëhet me ngritjen e dorës ose me ftesë që çdo njëri të deklarojë veç e veç.

6.2. Deklarimin e votimit veç e veç e cakton kryesuesi i mbledhjes.

6.3. Një nga një do të votohet edhe nëse për të kërkon një anëtarë i Këshillit Mbikëqyrës propozimin e të cilit e përkrahin më së paku 3 anëtarë.

6.4. Anëtarët e Këshillit Mbikëqyrës mund të votojnë “për” ose “kundër” propozimit për të cilin votohet ose të përmbahen nga votimi.

6.5. Nëse pas publikimit të rezultateve të votimit, vërtetohet se numri I votave “për” dhe numri i votave “kundër” bashkërisht me numrin e atyre që janë përmbajtur nga votimi janë të barabartë, votimi do të përsëritet. Në rast se edhe me rivotim nuk është arritur shumica e duhur, konsiderohet se propozimi është miratuar.

Neni 7

Të drejtat e përgjithshme të anëtarëve të Këshillit Mbikëqyrës të OEK-ut:

7.1.1 Të jetë i rregullt në mbajtjen e mbledhjeve të Këshillit Mbikëqyrës.

7.1.2. Çdo anëtar ka të drejtë të jetë aktiv në mbikëqyrjen e zhvillimeve të OEK-ut.

7.1.3. Të ndërhyjë dhe të marrë pjesë në përpilimin e rregullores së KM të OEK-ut.

7.1.4. Të marrë pjesë aktive në zhvillimin e aktiviteteve të Këshillit Mbikëqyrës të OEK-ut.

7.1.5. Të propozojë pikat e rendit të ditës dhe shqyrtimin e çështjeve të mbledhjeve të Këshillit Mbikëqyrës.

7.1.6. Të kërkojë sqarime mbi veprimtaritë e Këshillit Mbikëqyrës.

7.1.8. Të jetë aktiv në proceset e përpilimit të raportit të punës të Këshillit Mbikëqyrës.

Neni 8

8.1. Detyrat specifike të Këshillit Mbikëqyrës të OEK-ut:

8.1.1 Mbikëqyrë dhe përcjell afarizmin financiar të OEK-ut.

- 8.1.2 Përcjellë, mbikëqyrë dhe e kontrollon veprimtarin financiare dhe materiale të OEK-ut.
- 8.1.3.I propozon Këshillit Drejtues marrjen e masave dhe veprimeve në rastet kur vlerëson se ka shkelje ligjore nga anëtarët e OEK-ut.
- 8.1.4.Këshilli Mbikëqyrës i OEK-ut për punën e vet i përgjigjet Kuvendit të OEK-ut.
- 8.1.5.Këshilli Mbikëqyrës bashkëpunon me kryesuesin e vet, Këshillin Drejtues dhe anëtarët e OEK-ut, duke respektuar shkathtësitë e komunikimit dhe etiken profesionale.

Neni 9
DISPOZITAT PËRFUNDIMTARE

Dispozitat e kësaj Rregullore janë të aplikueshme për të gjithë anëtarët e Këshillit Mbikëqyrës të OEK-ut.

Neni 10
Hyrja ne fuqi

Kjo Rregullore hynë në fuqi ditën e miratimit nga ana e Këshillit Mbikëqyrës të Odës. Rregullorja ndryshohet dhe plotësohet në të njëjtën mënyrë siç është aprovuar.

KËSHILLI MBIKËQYRËS I OEK
Prishtinë: 31.05.2019

Kryesues i Këshillit
Ibrahim Tahiri

